

BIBLIOGRAFIA
Nr. 268, datë 18.1.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar; në VKM-në nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror (KDZH) në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare ka deklasifikuar informacionet e klasifikuara “Konfidencial”, si më poshtë:

a) Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dokumenti me shkresën përcjellëse nr. 11/10 prot., datë 2.12.2019, “Projekt i Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31”, me nivel klasifikimi “Konfidencial”, në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, dhe të vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, neni 4, germa “a”.

2. Arsyet për deklasifikimin e dokumentit të sipërcituar, si më poshtë vijon:

Referuar shkresës së ardhur nga Ministria e Kulturës me nr. 4904, datë 7.11.2022, “Propozim për bashkëpunim në fushën e kulturës”.

Interesi që ky dokument të deklasifikohet diktohet nga interesa të tjerë të ndryshëm në krahasim me nevojën për të mbajtur dokumentin të klasifikuar.

Në vijim dhe të shkresës së sipërcituar të ardhur nga Ministria e Kulturës, grupet e punës kanë zhvilluar takime të njëpasnjëshme, duke analizuar prioritet dhe objektivat afatgjatë në mbështetje të programeve kulturore, të cilat do t’i ofrohen një publiku më të gjerë dhe që duhet të zhvillohen në ambientet e Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31.

Interesi për të ridimensionuar/rinovuar ambiente të Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31, në funksion të organizimeve dhe promovimeve të ndryshme artistike, kulturore etj., nga studiues vendës dhe të huaj, prevalon dhe është në funksion të përmirësimit dhe të zhvillimit të politikave favorizuese në fushën e krijimtarisë artistike për vendin tonë.

Implementimi i zbatimit të projektit në ridimensionimin e ambienteve të Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31, ka për qëllim të ruajë karakterin e saj ceremonial, por njëkohësisht të jetë edhe i hapur për publikun.

Duke qenë se, dokumenti “Projekti i Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31”, i klasifikuar “Konfidencial”, përbën një element të rëndësishëm për zhvillimin e procedurës së hapur të prokurimit publik, me objekt: “Rikonstruksioni i Rezidencës Qeveritare, Vila nr. 31”, ai duhet të deklasifikohet.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në web të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe në mënyra të tjera, ndërsa një kopje t’i dërgohet zyrtarisht DSIK-së.

DREJTOR
Dhurata Frashëri